

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive

Mjësia Org. Org. Jedini
Org. Unit *Orkhem*

Nr. Prot. Br. Prot.
Prot. No. *1298-49/2023*

Nr. i faqeve Broj stranica
No. pages: *2-3*

Data Datum
Date: *25.07.2023*

Dalëse PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Ramiz Lladrovci , Kryetari i Komunës së Drenasit Milaim Hajdari , Kryesues i Kuvendit të Komunës	
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Trim Berisha , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Përmes:	Resul Makreshi , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	
Nga:	Klit Shala , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Datë: 21.07.2023
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zytari hartues i vlerësimit ligjor Bora Duli , Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve 2. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	Referencë: 165/2023
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Drenasit	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuari Kryetar z. Lladrovci,
I nderuari Kryesues z. Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimin 02 Nr.400/01-31031/23, për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake</i>
<i>I miratuar më datë 29.06.2023</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 30.06.2023</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 03.07.2023</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të mësipërme të Komunës së Drenasit, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Me anë të aktit administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit, Komuna e Drenasit ka synuar bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të komunës, nga viti 2022 dhe vitet paraprake në vitin aktual fiskal. Në efekt, kjo nënkupton bartje të balanceve të pashpenzuara me qëllim të rritjes së kufirit të shpenzimit të përcaktuar me ligjin përkatës për ndarje buxhetore.
2. Për qëllime të këtij vlerësimi, është relevante të theksohet se proceset e mësipërme evidentohen edhe në legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, dhe Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.
3. Si pikë e parë, Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal në nenin 1, ka përkufizuar të hyrat vetanake si të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna nga burimet e përcaktuara në Nenin 8 të Ligjit, nen i cili përcakton burimet e të hyrave vetanake.
4. Kështu, në kuptim të bartjes së balanceve të pashpenzuara, neni 27 i LMFPP-së përcakton se të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal skadojnë në fund të vitit, me përjashtim të

ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të hyrat vetanake të pashpenzuara të komunave, si në vijim:

Neni 27
Skadimi i Ndarjeve Buxhetore

Të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal do të skadojnë në mesnatën e 31 Dhjetorit, me përjashtim të ndarjeve buxhetore të cilat ndërlidhen me të ardhurat vetanake të pashpenzuara të komunave, apo të ndonjë organizate tjetër buxhetore të cilës i janë lejuar me ligj, e të cilat barten në vitin vijues.

5. Konstatimi i mësipërm konkretizohet edhe më tej me nenin 9, paragrafin 6 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-213 dhe Ligjin Nr. 08/L-235, ku komunave u lejohej bartje e bilanceve të pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2022 dhe nga vitet paraprake për vitin fiskal 2023.

Neni 9

Ndarja dhe ri-ndarja e fondeve të bartura si dhe obligimet e pakryera financiare nga viti paraprak


6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të komunave nga viti fiskal 2022 dhe vitet paraprake, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të LMFP-së, duke ruajtur strukturën e shpenzimeve dhe aprovuar me vendim të Kuvendit të Komunes.

6. Si rrjedhojë, Komunitat kanë të drejtë që bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetanake të cilat janë mbledhur [theks i shtuar] nga komunitat në vitin 2022 dhe në vitet paraprake t'i bartin në vitin fiskal 2023.
7. Si parim, të gjithë kufijtë buxhetor të përcaktuar me ligjin përkatës për ndarje buxhetore skadojnë me datë 31 dhjetor të atij viti përkatës fiskal. Mirëpo, LMFP në nenin 27, të precizuar edhe me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, vendos një përjashtim për procesin e bartjes së bilanceve të pashpenzuara ku thuhet se komunitat kanë të drejtë të bartin të hyrat e tyre vetanake nga viti fiskal 2022 dhe vitet paraprake në vitin aktual fiskal,.
8. Si përfundim, **Ministria konstaton Komunitat kanë të drejtë të bartin të hyrat vetanake të mbledhura dhe pashpenzuara nga viti 2022 dhe vitet paraprake në vitin 2023 me qëllim të rritjes së kufirit të shpenzimeve të përcaktuar me ligjin përkatës për ndarje buxhetore.** Më tej, realizimi i suksesshëm i vendimit kushtëzohet me përputhshmërinë e materialeve përcjellëse të lëndëve të proceduara nga Komuna në raport me udhëzimet dhe/apo rekomandimet e Departamentit të Buxhetit. Kjo nënkupton se vendimet e organizatave buxhetore mund të pësojnë ndryshime, konform rekomandimeve teknike të dhëna nga Departamenti i Buxhetit në Ministri.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Drenasit dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Gillogocit Kryesuesi i KK - Gillogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 30.06.2023 VI- 020-539
Zyrtarët përgjegjës:	Gezim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zytare e Lartë për Monitorim të Komunave Shkresë përcjellëse në MFPT	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës		
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse		
Lënda:	Shkresë përcjellëse në MFPT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin 02 Nr.400/01-31031/23, për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake, i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Gillogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02 Nr.400/01-31031/23, për rritjen dhe bartjen e të hyrave vetanake

I miratuar më datë: 29.06.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.06.2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit (Glogoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 400/01-31031 dt. 29.06.2023



Bazuar në nenin 11,12, dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës"), Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.06.2023, miratoi këtë:

VENDIM
PËR RITJEN DHE BARTJËN E TË HYRAVE VETANAKE

Neni 1

Me këtë vendim, miratohet rritja dhe bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023. Mjetet për rritje dhe bartje, janë të hyrat vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit të kaluar dhe viteve tjera.

Neni 2

Të hyrat vetanake për rritje janë në shumë prej: 1,146,544.88 euro dhe të hyrat e pa shpenzuara e që duhet të bartën nga fondi (21) janë në shumë prej: 270,637.98 euro dhe nga fondi burimor (22) në shumë prej: 207,425.26 euro.

Neni 3

Totali i mjeteve për rritje dhe bartje, në shumë prej: 1,624,608.12 euro barten në këto kategori ekonomike:

Mallra dhe Shërbime	382,722.96 euro
Shpenzimet Komunale	24,000.00 euro
Subvencione dhe Transfere	53,853.81 euro
Shpenzime Kapitale	1,164,031.35 euro

Neni 4

Shuma e mjeteve për bartje nga rritja/tejkalmimi i realizimit të të hyrave kundrejt planifikimit dhe nga bilanci i pashpenzuar i fondit 21 nga viti paraprak , në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon:

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:.....	30,391.47 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100) në vlerë prej:	6,528.00 €
Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66310) në vlerë prej:.....	19,938.48 €
Infrastruktura Rrugore(18001) në vlerë prej:.....	12,361.49 €

Administrata (16301) në shumë prej:.....	30,000.00 €
Planifikimi i Zhvillimit Ekonomik (48001) në vlerë prej:.....	17,000.00 €
Infrastruktura Publike (18161) në vlerë prej:.....	20,000.00 €
Bujqësia (47001) në vlerë prej:.....	32,000.00 €
Arsimi Parashkollor (92210) në vlerë prej:.....	12,242.98 €
Administrat (92005) në vlerë prej:.....	108,642.60 €

Në kategorinë e Shpenzime Komunale në në programin:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	24,000.00 €
--	-------------

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në vlerë prej:.....	10,485.04 €
Administrata (73010) në vlerë prej:.....	12,083.01 €
Zyra e Kryetarit (16001) në vlerë prej:	617.56 €
Administrata (92005) në vlerë prej:	1,150.10 €
Shërbimet Kulturore (85001) në vlerë prej:.....	24,000.00 €

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001) në projektin:

“Rregullimi dhe kultivimi i sipërfaqeve gjelbëruese, druj dekorativ”, kodi (53313) në vlerë prej:.....5,751.00 €

Infrastruktura Publike (18161) në projektet:

“Zgjerimi dhe ndërtimi i Sheshit “Fehmi e Xhevë Lladrovci” Drenas, kodi (49297) në vlerë prej:.....900,000.00 €

“Rregullimi i shtratit të lumit Drenica – Verbica”, kodi (48254) në vlerë prej:.....4,876.17 €

“Asfaltimi i rrugës në fshatin Arllat, Negroc, Gjergjicë si dhe Bytyq, kodi (48646) në vlerë prej:.....65,752.50 €

“Asfaltimi i rrugës Zabel i Ulët e Epërme, Korroticë e Ulët dhe Epërme”, kodi (48658) në vlerë prej:.....51,296.90 €

“Kanalizimi i ujërave të zeza Sankoc, Fushticë e Epërme dhe Ulët, kodi (48705) në vlerë prej:

Neni 5

Shuma e mjeteve për bartje nga bilanci i pashpenzuar i fondit 22 nga viti paraprak, në nënprogramet dhe kategoritë e shpenzimeve si vijon :

Në kategorinë e shpenzimeve Kapitale në nën programet dhe projektet si vijon:

Infrastruktura Publike (18161) në projektin:

"Zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit "Fehmi e Xheva Lladrovci",kodi (49297) në vlerë prej:.....108,289.22 €

Në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime në nën programet si vijon:

Shërbimet Kadastrale (65005),në vlerë prej:.....74,665.68 €
Administrata (16301),në vlerë prej:.....2,806.42 €
Planifikim Urban dhe Inspeksioni (66310),në vlerë prej:.....458.52 €
Shërbimet e Shëndetësisë Primare (73100), në vlerë prej:.....108.00 €
Arsimi Parashkollor (92210),në vlerë prej:.....15,579.32 €

Në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere në nën programet si vijon:

Infrastruktura Rrugore (18001), në vlerë prej:.....4,168.20 €
Administrata (92005), në vlerë prej:.....1,349.90 €

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryeshtesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

Arsyetim

Rritja e të hyrave vetanake në shumë prej: 1,146,544.88 euro është si rezultat i tejkalimit të të hyrave vetanake të planifikuara dhe në pamundësi për alokimin e tyre në vitin 2022, janë bart dhe do të perdoren për zhvillimin e projekteve të parapara për vitin 2023, ndersa mjetet e pa shpenzuara në vitin 2022 janë parapa për mbulimin e projekteve të cilat kanë qenë dhe janë në zhvillim në vitin 2023.